

# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM**  
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **211-26-1632-2-2-1**  
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **“Hartimi i projekteve per ndërtimin dhe renovimin e shtëpive per nevojat e MKK-se”**  
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Archi D projekt SH.P.K.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rr.Xheladin Hana Bll 9 Bregu i Diellit, Nr.6**

(Adresa)

**Prishtinë**

(Vendi)

**10000**

(Kodi postar)

**049/131374**

(Numri Telefonit)

**N/A**

(Numri i Faks-it)

**Edona Haliti**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**archidprojekt.shpk@gmail.com**

(Adresa elektronike)

**14.04.2026**

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË. Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- 05 Njoftim per Kontrat 26.03.2026
- Kërkesa për rishqyrtim: 30.03.2026
- Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim: 02.04.2026

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	Jo
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Procedura eshte ende ne fazen tendruese	

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shpesh nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	Jo
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Kërkesa për rishqyrtim: 30.03.2026</li><li>• Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim: 02.04.2026</li></ul>	

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

- Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:
- Neni 1 i LPP: Qëllimi
- Neni 7 i LPP: Barazia në trajtim jo diskriminimi
- Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik- RrUOPP
- Neni 40 Njoftimi i Kontratës
- Neni 51 Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes
- Neni 52 Njoftimi i kriteve për dhënien e kontratës
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimi
- Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të RrUOPP-se.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne, si kompani palë e interesit, të pakënaqur me Njoftimin për Kontratë dhe pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim – kërkesë e cila është pranuar pjesërisht – konstatojmë se disa nga pretendimet tona nuk janë marrë parasysh. Duke pasur parasysh shkeljet e evidentuara, të cilat janë refuzuar pa arsytim të mjaftueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe ligjshmërisë dhe brenda afatit ligjor, konform Nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, ushtroni këtë:

## ANKESË

Ne do të parashtrojmë në Ankesë pretendimet tona të cilat nuk janë trajtuar/refuzuar nga ana e Autoritetit Kontraktues.

### VENDIM

I. Aprovohet si pjesërisht e bazuar Ankesa – Kërkesa për rishqyrtim e OE Archi D Projekt të datës 30.03.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Hartimi i projekteve për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive për nevojat e MKK-se" me numër prokurimi: MKK – 211/26/001/221

### Arsytim

Autoriteti Kontraktues Ministria për Komunitete dhe Kthim pas pranimit të Ankesës tuaj me datën 30/03/2026 për aktivitetin e prokurimit: "Hartimi i projekteve për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive për nevojat e MKK-se" me numër prokurimi: MKK –211/26/001/221 ka shqyrtuar ankesën tuaj dhe aprovohet si pjesërisht e bazuar pretendimet ankimore në këto pika : Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa nr.8 pika 10, Kërkesa nr.9 dhe Kërkesa nr.10 , ndërsa kërkesat tjera mbesin sipas dosjes së tenderit.

Autoriteti Kontraktues në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim ka deklaruar se ka aprovuar Kërkesën nr. 8 pika 10, Kërkesën nr. 9 dhe Kërkesën nr. 10, mirëpo nga analiza e dokumentacionit të publikuar rezultoi qartë se këto kërkesa nuk janë ndryshuar fare dhe kanë mbetur identike me ato të përcaktuara në dosjen fillestare të tenderit.

Kjo paraqet një mospërputhje të dukshme ndërmjet asaj që është deklaruar në përgjigjen e Autoritetit Kontraktues dhe gjendjes faktike në dokumentet e tenderit. Një veprim i tillë krijon pasiguri juridike për operatorët ekonomikë dhe cenon parimet themelore të transparencës dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik. Nëse një kërkesë pretendohet se është aprovuar, atëherë Autoriteti Kontraktues ka obligim që të reflektojë këtë ndryshim në mënyrë konkrete në dosjen e tenderit, duke bërë korrigjimet përkatëse dhe duke i bërë ato të qasshme për të gjithë operatorët ekonomikë. Mosreflektimi i këtyre ndryshimeve dëshmon se në praktikë kërkesat në fjalë nuk janë aprovuar, pavarësisht deklarimit formal. Andaj, konsiderohet se pretendimi i Autoritetit Kontraktues për aprovimin e Kërkesës nr. 9 dhe nr. 10 është vetëm formal dhe jo real, pasi nuk është shoqëruar me ndryshime konkrete në përmbajtjen e dosjes së tenderit. Kjo përbën shkelje të parimeve të transparencës dhe sigurisë juridike, si dhe vendos operatorët ekonomikë në pozitë të pabarabartë. Për këtë arsye, kërkohet nga organi shqyrtues që të konstatojë këtë mospërputhje dhe të obligojë Autoritetin Kontraktues që të bëjë ndryshimet reale dhe të dukshme në dosjen e tenderit, në përputhje me vendimin për aprovimin e kërkesave, në mënyrë që të garantohet një proces i drejtë, transparent dhe konkurrues.

- [Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 9\) Nje inxhinier I diplomuar i elektro teknikes drejtimi Elektroenergjetike industriale - sistemi 5 vjeqar ose master \(min5. vite pervoj pune nga diplomimi\)](#)

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për angazhimin e një (1) inxhinieri të diplomuar të elektroteknikës, me drejtim specifik në elektroenergjetikë industriale, konsiderohet kërkesë kufizuese dhe jo proporcionale me natyrën e projektit. Në përputhje me parimet e Ligjit për Prokurim Publik, kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë të arsyeshme, proporcionale dhe të mos kufizojnë konkurrencën në mënyrë të panevojshme. Kufizimi i profilit vetëm në drejtimin elektroenergjetikë industriale është i panevojshëm, pasi projektet në fjalë nuk kanë karakter industrial. Një inxhinier i elektroteknikës me drejtime të tjera relevante (si energjetikë, instalime elektrike, apo sisteme elektroenergjetike në përgjithësi) posedon kompetenca të mjaftueshme për realizimin e detyrave të kërkuara. Kjo kërkesë në mënyrë të panevojshme ngushton konkurrencën, duke përjashtuar profesionistë të kualifikuar që nuk janë të profilizuar pikërisht në drejtimin industrial, por kanë përvojë të përshtatshme në projekte të ngjashme. Prandaj, kërkesa duhet të riformulohet duke lejuar angazhimin e një inxhinieri të diplomuar të elektroteknikës me përvojë relevante profesionale, pa kufizim në një drejtim specifik si elektroenergjetika industriale.

- Kërkesa 10, para paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, ka qenë si në vijim:  
Nje inxhinier ose Master Infrastruktura rrugore i certifikuar per perdorimin e softëerit professional Plateia , te jete ekspert per siguri dhe shendet ne pune i certifikuar nga Ministria e Punes dhe Mireqenjes Sociale

Ndërsa pas kërkesës sonë për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka modifikuar kërkesën duke e lënë vetëm si: një inxhinier ose Master i Infrastruktura Rrugore, duke larguar kërkesat për certifikime. Megjithatë, edhe në këtë formë, sqarojmë se kjo kërkesë mbetet e panevojshme. Në bazë të paramasës dhe parallogarisë së projektit, nuk janë paraparë punë që lidhen me këtë profil profesional. Si rrjedhojë, kërkesa rezulton e pajustificuar dhe jo relevante për realizimin e kontratës. Vendosja e një kriteri të tillë nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e punëve të parapara dhe sipas paramasës dhe parallogarisë, për më tepër, krijon kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë, duke e bërë këtë kriter potencialisht favorizues. Për këto arsye, kërkojmë që ky kriter të largohet në tërësi, si i panevojshëm dhe jo në përputhje me kërkesat reale të projektit.

- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2-

Kërkesa 9. Paisjet Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se posedon paisjet gjeodezike si me posht:  
Dy(2) paisje gjeodezike per rilevim te pikave - Stacion Total Robotic. Te pakten njeri nga ta te jete full robotic dhe saktesi te majtes kendore jo me pask se 1”

Dy(2) paisje per rilevim te pikave GNSS (baze+rover) me mundesi operimi ne RTK dhe matje statike.

Nje (1) Softëer per barazim te pikave gjeodezike

Nje(1) marres Lidar(laser scanner) te dores me mundesi te skanimimit minimum 200000 pika ne sekond dhe operim minimumi 2x 90 minuta me mundesi operimi RTK dhe minimumi 2 kamera te integruara me nga 12 MP secila.

Kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues lidhur me pajisjet gjeodezike janë qartazi të panevojshme dhe të pajustificuara në raport me natyrën dhe përmasat e projektit në fjalë.

Obligimi për posedimin e një numri kaq të madh dhe njëkohësisht specifik të pajisjeve të avancuara teknologjike, si stacione totale robotike me saktësi shumë të lartë, pajisje GNSS me funksionalitete të plota (RTK dhe matje statike), softuer të specializuar për barazim, si dhe skaner LiDAR dore me specifika të detajuara, tejkalon nevojat reale të realizimit të kontratës. Këto kërkesa nuk janë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi vendosin barriera të panevojshme për pjesëmarrje dhe kufizojnë ndjeshëm konkurrencën në treg. Një qasje e tillë e Autoritetit Kontraktues krijon avantazh të padrejtë për operatorë të caktuar ekonomikë që mund të posedojnë këtë kombinim specifik të pajisjeve, duke përjashtuar në mënyrë indirekte operatorë të tjerë të kualifikuar që janë plotësisht të aftë për realizimin e projektit përmes mjeteve alternative. Andaj, këto kërkesa duhet të konsiderohen si të panevojshme, të tepruara dhe kufizuese për konkurrencën, duke rrezikuar cenimin e parimeve themelore të prokurimit publik, përfshirë trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe sigurimin e konkurrencës efektive. Për këtë arsye, kërkohet që Autoriteti Kontraktues të rishikojë dhe të eliminojë këto kritere të panevojshme, duke i përshtatur ato në mënyrë proporcionale me kërkesat reale të projektit dhe duke mundësuar një proces të hapur dhe të drejtë konkurrues.

- Kërkesa 10, para paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, ka qenë si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 10. Siftëer per projekte me licence

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon Licence per Archicad ;

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon Licence per Plateia ;

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon Licence per Autocad ;

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon Licence per Softëare per llogari statike ;

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon softëer me licence ne pronesi per pejektimin, modelimin dhe llogaritjen e furnizimit me uje dhe kanalizim fekal

Autoriteti Kontraktues pas kërkesës për rishqyrtim janë paraqitur kërkesa për paisje si në vijim :  
Kërkesa 10. Siftëer per projekte me licence – Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon Licence per Archicad ;

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon Licence per Plateia ;

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon Licence per Autocad ;

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon Licence per Softëare per llogari statike ;

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se posedon softëer me licence ne pronesi per pejektimin, modelimin dhe llogaritjen e furnizimit me uje dhe kanalizim fekal

Autoriteti Kontraktues ka lënë në fuqi kërkesën për dëshmi që duhet të ofrohen nga operatori ekonomik, duke specifikuar se në rast të ofertimit si konzorcium, lideri dhe të gjithë anëtarët duhet t'i posedojnë secili veçmas të gjitha licencat e softuerëve të kërkuar. Edhe pas rishqyrtimit, kjo kërkesë është mbajtur në fuqi në mënyrë të pajustificuar, duke qenë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 26 – Grupi i Operatorëve Ekonomikë. Ky nen përcakton qartë se operatorët ekonomikë kanë të drejtë të bashkohen dhe të mbështeten në kapacitetet e përbashkëta për përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale, pa qenë e nevojshme që secili anëtar individualisht të përmbushë të gjitha kriteret. Qëllimi i kësaj dispozite është nxitja e konkurrencës dhe mundësimi i pjesëmarrjes sa më të gjerë në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kontekst, insistimi që secili anëtar i konzorciumit të posedojë të gjitha licencat e softuerëve (si Archicad, Plateia, Autocad, softuer për llogari statike dhe softuer për projektim të ujësjellësit dhe kanalizimit) përbën kërkesë të tepruar, joproportionale dhe në kundërshtim me frymën e ligjit. Një kërkesë e tillë nuk është e domosdoshme për realizimin e kontratës dhe njëkohësisht kufizon ndjeshëm mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke reduktuar konkurrencën në mënyrë artificiale. Në praktikë, është plotësisht e mjaftueshme që këto kapacitete të sigurohen nga një ose disa anëtarë të grupit, në mënyrë që i gjithë konzorciumi të përmbushë kërkesat, pa qenë e nevojshme që secili anëtar të posedojë individualisht të gjitha licencat. Andaj, kërkesa e Autoritetit Kontraktues që lideri dhe të gjithë anëtarët e konzorciumit të posedojnë secili të gjitha licencat e softuerëve është në kundërshtim me Nenin 26 të LPP-së, është diskriminuese dhe kufizuese për konkurrencën, dhe si e tillë duhet të shfuqizohet ose të riformulohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga ana juaj si Organ Shqyrtues i Prokurimit të të merret:

#### V E N D I M

- **Aprovohet** ankesa jonë si e bazuar;
- **Anulohet** Njoftimi për Kontratë;
- **Obligohet** Autoriteti Kontraktues që të rishikojë dhe të analizojë kriteret e vendosura, duke i përshtatur ato me natyrën, përmasat dhe kërkesat reale të kontratës, në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe konkurrencës së lirë.

#### **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

#### **Mundësia e konkurimit**

#### **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"